




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT
Komisioni Komunal i Aksionarëve të NP “Tregu”

DATE/A:	13.05.2023
REFERENCË:	
PËR/ZA/TO:	Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa Anëtarët e Kuvendit të Komunës
NGA/OD/FROM:	Xhafer Preteni - Kryetar i Komisionit Komunal të Aksionarëve të NP “Tregu” 
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raport vjetor i punës për vitin 2023

Me datë 25.01.2023 është mbajtur mbledhja e parë, për vitin 2023, e Komisionit Komunal të Aksionarëve të NP “Tregu”.

Komisioni Komunal i Aksionarëve të NP “Tregu” gjatë vitit i ka mbajtur gjithësejt 6 mbledhje të rregullta dhe disa takime me Bordin e Drejtorëve të NP “Tregu”.

Në fillim të vitit Komisioni Komunal i Aksionarëve të NP “Tregu” hartoi Raportin Vjetor Punës për Vitin 2022 i cili u dërgu KPF-së dhe përmes tij Kuvendit të Komunës.

Me datë 27.03.2023 Bordi i Drejtorëve të NP “Tregu”, pas shqyrtimit të rezultateve emëron Kryeshefin Ekzekutiv të ndërmarrjes.

Më pastaj Komisioni Komunal i Aksionarëve të NP “Tregu” shqyrtoi të gjitha materialet, duke përfshirë edhe procesverbalet e sjella nga Bordi i Drejtorëve të NP “Tregu” në lidhje me procesin e përzgjedhjes së Kryeshefit Ekzekutiv të ndërmarrjes dhe pas përfundimit të afatit të ankesave konstatoi që procesi i zgjedhjes së kryeshefit ishte në rregull.

Në Muajin Korrik u hartua Statutit i NP “Tregu”. Ky statut u hartua konform dispozitave Ligjit Nr. 06/L–016, për Shoqëritë Tregtare, dispozitave të Ligjit Nr. 03/L – 087, për Ndërmarrjet Publike ku u përcaktuan parimet themelore për organizimin dhe punën e Ndërmarrjes Publike Lokale “Tregu” Sh. A., në Mitrovicë, aktivitetet e

ndërmarrjes, përgjegjësitë e ndërmarrjes, Bordit të Drejtorëve, aksionarëve, Komisionit të Auditimit, Kryeshefit Ekzekutiv, Zyrtarit Kryesor Financiar, Auditorit të Brendshëm, dispozitat e veçanta dhe dispozitat përfundimtare.

Ku statut iu dergua Zyrës Ligjore për interpretim të ligjshmërisë. Pas kthimit të interpretimit dhe më rekomandimin e tyre në disa qështje teknike u përfundua dhe dhe në muajin Nëntor u miratua.



Në muajin Nëntor Komisioni Komunal i Aksionarëve të NP “Tregu” në zbatim të nenit 20, paragrafi 2, të Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111 dhe Ligjin Nr. 05/L-009, vendosi që të ngritë pagën e anëtarëve të Bordit të Drejtorëve.

Gjatë vitit NP “Tregu” u janë ndarë mjetet nga subvencionimi komunal me vlerë prej 30.000 euro me të cilat ndërmarrja ka bërë përmirsimin e infrastrukturës së tregut dhe inventarizimin e zyreve.

Komisioni Komunal i Aksionarëve të NP “Tregu” gjatë gjithë vitit ka bashkëpunuar me Bordin e Drejtorëve në përmirsimin dhe ngritjen e shërbimeve të ndërmarrjes duke iu dhënë rekomandime dhe duke kërkuar raporte në bazë të ligjeve dhe rregulloreve në fuqi.

Së bashku më këtë raport është i bashkangjitur Raporti Vjetor i Punës për vitin 2023 dhe Plani Vjetor i Punës për Vitin 2024 nga Bordi i Drejtorëve të NP “Tregu”.

Me respekt!

	<p><i>REPUBLIKA E KOSOVËS</i> <i>REPUBLIKA KOSOVA/</i> <i>REPUBLIC OF KOSOVA</i></p>	
	<p><i>KOMUNA E MITROVICËS</i> <i>SKUPSTINA OPSTINA</i> <i>MITROVICA MUNICIPALITY</i></p>	
	<p><i>Ndërmarrja Publike Lokale "TREGU" Sh.A. -</i> <i>Mitrovicë</i></p>	

RAPORTI VJETOR I PUNËS

JANAR – DHJETOR 2023

FJALA E KRYESHEFIT EKZEKUTIV



MUSA PRETENI

KRYESHEF EKZEKUTIV

Viti 2023 në përgjithësi mund të konsiderohet si vit i sukseshëm në Ndërmarrjen Publike Lokale “Tregu” Sh.A., Mitrovicë, për shkak të punës që është bërë për këta 12 muaj. Intensiteti dhe efikasiteti në punë konsideroj që janë shtyllat kryesore mbi të cilat bazohet suksesi i këtij viti, i cili megjithatë nuk ka qenë i lehtë për shkak të vështirësive të shumta në të cilat e kam gjetur ndërmarrjen dhe të tjerave që kanë dalë gjatë rrugës.

Me të marrë mandatin në fillim të prillit të vitit 2023, kam përcaktuar qartë objektivat dhe misionin e ndërmarrjes që pastaj kanalizimi i punës të jetë më i lehtë. Jemi treguar modest në përcaktimin e këtyre objektivave me qëllim që të arrihen përmes rezultateve të prekshme dhe të matshme. Normalisht që arritja e objektivave nuk ka qenë e lehtë, por me vendosjen e rregullit në mesin e punëtorëve dhe menaxhmentit në përgjithësi, kjo gjë ka qenë e arritshme, dhe konsideroj që kemi prekur rezultate të kënaqshme.

NPL "Tregu" Sh.A., menaxhon me hapësirën ku zhvillohet veprimtaria tregtare gjatë ditës së shtunë në komunën e Mitrovicës. Tregu është hapësirë e destinuar për shitjen e produkteve vendore dhe mundësi për qytetarët që të furnizohen me këto produkte. Andaj bazuar në këtë destinim edhe qëllimi ynë si ndërmarrje ka qenë që këtë hapësirë ta shndërrojmë në një vend të përshtatshëm për shitësit dhe qytetarët.

Gjatë vitit 2023 hapësirën e tregut në Mitrovicë e kemi shndërruar në një ambient atraktiv dhe njëkohësisht të përshtatshëm me kushte të volitshme për zhvillimin e veprimtarisë tregtare. Tregun e kemi transformuar nga një vend me kushte minimale të operimit në një vend me kushte optimale, falë punës së menaxhmentit dhe secilit punëtor. Kjo hapësirë ofron mundësi, kushte dhe siguri për operim për çdo ditë të javës, por fatkeqësisht për shkak të faktorëve të shumtë, shitësit ofrojnë shitjen e produkteve të tyre vetëm ditën e shtunë. Për shkak të faktorëve të tjerë ekonomikë dhe social po ashtu ndër vite numri i shitësve ka rënë, por nga ky vit e tutje konsideroj që ata mund të operojnë shumë më suksesshëm se sa vitet e kaluara. Synim i yni mbetet ngritja e numrit të shitësve në këtë hapësirë për shkak të çmimeve të ulëta të operimit dhe kushteve shumë të mira.

Gjatë vitit 2023 kemi vendosur rregull në funksionimin e ndërmarrjes, përmes vendosjes së disiplinës në mesin e punëtorëve, kështu duke mbuluar hapësirën e tregut me punëtorët tanë 6 ditë në javë, me përjashtim të ditës së diel. Nga ora 08:00 deri në ora 16:00 tregu është në dispozicionin e shitësve, ku kanë mundësi që të shesin produktet që ofrojnë. Në rast se ka rritje të kërkesës së shitësve për operim në hapësirën e tregut të qytetit ne jemi në dispozicion që të zgjasim orarin e punës në varësi të kërkesave të tyre.

Shkurtimisht do të përpiqem që të përmend disa nga punët e bëra për ndryshimin e pamjes së tregut dhe njëkohësisht krijimit të kushteve shumë më të mira për shitësit dhe qytetarët në treg. Përmes projektit për renovim kemi rregulluar rrethojat e hapësirës së tregut, duke i dhënë pamjen dhe

funksionin e një ambienti të përshtatshëm për punë dhe sigurisë së nevojshme për secilin që frekuenton hapësirën. Pamje e gjelbër simbolizon pikërisht funksionin e tregut si një hapësirë për shitjen e këtyre produkteve. Kemi rregulluar po ashtu hapësirën e brendshme për shitjen e produkteve të qumështit, duke rregulluar tavolina të reja nga materiali adekuat për shitjen e këtyre produkteve. Në hapësirën për produkte të qumështit kemi montuar lavamane të nevojshme për pastërti. Sistemi i ajrosjes e ka shndërruar këtë hapësirë në optimale për shitësit dhe qytetarët. Sistemi ndriçimit është vendosur brenda hapësirës së brendshme.

Janë funksionalizuar tërësisht toaletet me të gjitha mjetet dhe kushtet e nevojshme për shitësit dhe qytetarët, gjë që më herët nuk kanë qenë në dispozicion. Sot toaletet e tregut ofrojnë të gjitha kushtet e nevojshme, gjë që përcillet me mirëmbajtje të vazhdueshme të pastërtisë nga stafi i ndërmarrjes.

NPL “Tregu” Sh.A., ka përbushur objektivat për vitin 2023 dhe synon që të njëjtën ta bëjë në vitin 2024, duke rritur inkasimin dhe njëkohësisht duke rritur numrin e shitësve brenda tregut përmes krijimit të kushteve të përshtatshme për veprimtarinë tregtare.

Në fund dua të falënderoj secilin tregtar që ka zgjedhur hapësirën e tregut për shitjen e produkteve vendore, falënderoj secilin punëtor për gatishmërinë për punë në çdo kohë dhe në çdo rrethanë. Bordi i Drejtorëve dhe Komisioni i Aksionarëve janë shtyllë e rëndësishme e funksionimit të ndërmarrjes, andaj falënderimi për secilin prej tyre. Dhe krejt në fund, jo për nga rëndësia, falënderim për komunën e Mitrovicës dhe secilin anëtar të Asamblesë që mbështetën ndërmarrjen me subvencion.

1. HYRJE

Ndërmarrja Publike Lokale (NPL) "Tregu" Sh.A., Mitrovicë është ndërmarrje publike lokale, themeluar sipas Ligjit për Ndërmarrjet Publike të miratuar me datën. 20.06.2012 nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

NPL "Tregu" Sh.A., me të gjitha asetet e saj është ndërmarrje në pronësi të Komunës së Mitrovicës së Jugut.

Mbështetur në nenin 35 të Ligjit Nr.02/L-123 për "Shoqëritë Tregtare" si dhe me dispozitat e Ligjit Nr.04/L-006 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit bazë për shoqëritë tregtare të Kosovës, themeluesi i Shoqërisë Aksionare – Kuvendi Komunal i Mitrovicës, përfaqësohet nga Komisioni i Aksionarëve, i cili edhe zgjedh Bordin e Drejtorëve të Ndërmarrjes.

Me të gjitha procedurat Ligjore, të parapara me Ligjin e Punës, është zgjedhur edhe Bordi

aktual i drejtorëve të NPL "Tregu" SH.A., Mitrovicë, në përbërje:

1. z. Eset Shaqiri - Kryesues i Bordit të Drejtorëve
2. z. Egzon Aliu - Anëtar i Bordit
3. z. Agron Sejdiu – Anëtar i Bordit
4. z. Rilind Kelmendi – Anëtar i Bordit

Bordi i Drejtorëve udhëheq me politikat e përgjithme zhvillimore të Ndërmarrjes me qëllim të realizimit të objektivave të parapara.

Bordi i Drejtorëve ushtron kontroll të vazhdueshëm mbi Kryeshefin Ekzekutiv dhe mbi

zyrtarët e tjerë të Ndërmarrjes, gjithmonë në vazhden e realizimit të objektivave sipas planeve operative.

Bordi i Drejtorëve përbëhet nga 4 Drejtorë jo-Ekzekutiv dhe një Drejtor Ekzekutiv, i cili njëherit është edhe Kryeshef Ekzekutiv i Ndërmarrjes me të drejtë vote në vendimmarrje të Bordit të Drejtorëve.

Kryeshefi Ekzekutiv zbaton politikat e përgjithshme zhvillimore të Ndërmarrjes të cilat në formën e vendimeve aprovohen nga Bordi në përputhshmëri me Ligjin mbi Ndërmarrjet Publike, Statutin dhe Rregulloret e Ndërmarrjes.

Andaj, Strukturën Organizative Menaxhuese në Ndërmarrje e përbëjnë:

- Kryeshefi Ekzekutiv

* Mungojnë pozitat tjera të rëndësishme menaxhuese siç është Zyrtari Kryesor Financiar dhe Sekretari i Përgjithshëm.

NPL “Tregu” ka gjithsej 9 të punësuar, nga ta: 1 shef i tregut, 1 arkatar, 3 inkasantë, 3 roje sigurimi dhe 1 pastrues. Nga ky vit rojet e sigurimit është marrë vendim që t’iu ndërrohet pozita e punës, dy nga ta do të punojnë si inkasantë, kurse njëri si pastrues.

Ndërmarrja ofron shërbime që synojnë të përmbushin kërkesat e e shitësve dhe qytetarëve për një hapësirë të përshtatshme në tregun e Mitrovicës për të realizuar veprimtarinë e shitblerjes.

Bazuar në Ligjin për Ndërmarrjet publike respektivisht Ligjin br.03/L-087, neni 14 për Raportime Financiare dhe nenit 31 për dorëzimin e Raporteve Tremujore, Ndërmarrja ka përgatitur këtë Raport e Punës për vitin 2023, përkatësisht muajt janar – dhjetor.

2. Historik i shkurt i NPL “Tregu” Sh. A., Mitrovicë


Ndërmarrja Publike Lokale “Tregu” Sh. A., Mitrovicë, është ndërmarrje lokale me pronësi 100% të aksioneve nga komuna e Mitrovicës. Kjo ndërmarrje është themeluar pas ndarjes nga KRM “Uniteti” dhe “Hortikultura” në vitin 1999.

NPL “Tregu” Sh.A., Mitrovicë, funksionon në bazë të Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Ligji nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Ligji nr. 05/L-009 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 04/L-111, si dhe Ligji nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare.

NPL “Tregu” Sh. A., Mitrovicë menaxhon hapësirën e tregut të gjelbër në Mitrovicë në sipërfaqe rreth 1 hektar. Tregu funksionon si hapësirë ku prodhuesit vendorë mund të shesin produktet e tyre vendore, po ashtu në menaxhim ndodhet edhe hapësira për shitjen e produkteve të qumështit.

NPL “Tregu” Sh. A., Mitrovicë me marrjen e detyrës si kryeshef ekzekutiv e kam gjetur në gjendje aspak të mirë financiare dhe menaxheriale. Disa nga problemet më të mëdha të kësaj ndërmarrje janë borxhet e mëdha që ka në Administratën Tatimore të Kosovës (kontribute pensionale dhe tatimore), borxhet në KRU “Mitrovica”, si dhe paga të konsiderueshme ndaj punëtorëve të kompanisë të cilat janë mbledhur ndër vite.

3. Organogrami i NPL “Tregu” Sh. A., Mitrovicë



4. RAPORTI FINANCIAR

4.1. Të hyrat vjetore (janar-dhjetor 2023)

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2023 NPL “Tregu” Sh.A., Mitrovicë ka gjeneruar të hyra gjithsej:.....77,588.00 €

NPL “Tregu” Sh.A., Mitrovicë ka realizuar të hyra nga inkasimi brenda hapësirës së tregut në Mitrovicë dhe qiratë.


- Të hyra në muajin janar janë: 2,260.00 €
- Të hyra në muajin shkurt janë: 3,954.00 €
- Të hyra në muajin mars janë: 4,350.00 €
- Të hyra për muajin prill janë: 4,974.00 €
- Të hyra për muajin maj janë: 2,631.00 €
- Të hyra për muajin qershor janë: 4,815.00 €
- Të hyra për muajin korrik janë: 4,885.00 €
- Të hyra për muajin gusht janë: 6,691.00 €
- Të hyra për muajin shtator janë: 5,475.00 €
- Të hyra për muajin tetor janë: 2,527.00 €
- Të hyra për muajin nëntor (përfshirë subvencionin nga komuna e Mitrovicës në shumën 30,000.00€) janë: 32,270.00 €
- Të hyrat për muajin dhjetor janë: 2,756.00 €
-

Paraqitja tabelare e të hyrave ndarë në muaj

MUAJI	TË HYRAT
JANAR	2,260.00 €
SHKURT	3,954.00 €
MARS	4,350.00 €
PRILL	4,974.00 €
MAJ	2,631.00 €
QERSHOR	4,815.00 €
KORRIK	4,885.00 €
GUSHT	6,691.00 €
SHTATOR	5,475.00 €
TETOR	2,527.00 €
NËNTOR	32,270.00 € <i>(Subvencion 30,000.00€)</i>
DHJETOR	2,756.00 €
TOALI	77,588.00 €

Tabela 1.

Paraqitja grafike e të hyrave gjatë muajve



Grafika 1.

***Paraqitja e detajuar e të hyrave gjatë dymbëdhjetë mujorit (janar-dhjetor) 2023:**

- Të hyra nga inkasimi për 12 muaj janë gjithsej.....**23,820.00€**

- Të hyrat nga qiratë për 12 muaj janë gjithsej.....**23,818.00€**

Vërejtje: Nga pagesa e qirasë për vitin 2023 nuk janë paguar edhe 4 muaj qira nga njëri prej qiramrësve në vlerë 8,720.00 euro.

- Subvencioni nga komuna e Mitrovicës.....**30,000.00€**


Paraqitja tabelare e të hyrave në formë të detajuar

Të hyrat	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Total
Inkasim	1,400.00€	1,424.00€	1,640.00€	2,264.00€	2,281.00€	2,105.00 €	2,292.00€	1,850.00€	2,522.00€	2,114.00€	1,497.00€	2,343.00€	23,820.00€
Qira	700.00€	2,530.00€	2,710.00€	2,710.00€	390.00€	2,710.00€	2,593.00€	4,773.00€	2,953.00€	413.00€	773.00€	413.00€	23,818.00€
Subvencion											30,000.00€		30,000.00€
Total	2,260.00€	3,954.00€	4,350.00€	4,974.00€	2,631.00€	4,815.00€	4,885.00€	6,691.00€	5,475.00€	2,527.00€	32,270.00€	2,756.00€	77,588.00€

Tabela 2.

Vërejtje: Në totalin e të hyrave nga inkasimi përfshihen edhe 282.00€ që janë inkasuar në javën e fundit të dhjetorit 2022 por janë deponuar në bankë në janar 2023. Po ashtu në të hyra të inkasimit përfshihen edhe 392.00€ që janë inkasuar në javën e fundit të dhjetorit 2023, por që në bankë janë deponuar në janar 2024.

Paraqitja grafike e të hyrave në mënyrë të detajuar




Grafika 2.

Krahasimi i të hyrave nga inkasimi 2022 – 2023

Muaji ↓ Viti →	2022	2023	Rritja në vlerë	Rritja në %
JANAR	721.00€	1,480.00€	759.00€	105.2%
SHKURT	1,049.00€	1,424.00€	375.00€	35.74%
MARS	1,030.00€	1,640.00€	610.00€	59.2%
PRILL	1,489.00€	2,264.00€	775.00€	52.04%
MAJ	1,435.00€	2,281.00€	846.00€	58.95%
QERSHOR	1,895.00€	2,105.00 €	210.00€	11.08%
KORRIK	1,619.00€	2,292.00€	673.00€	41.56%
GUSHT	1,689.00€	1,858.00€	169.00€	10%
SHTATOR	1,351.00€	2,522.00€	1,171.00€	86.67%
TETOR	2,043.00€	2,114.00€	71.00€	3.47%
NËNTOR	1,575.00€	1,497.00€	-78.00€	-4.95%
DHJETOR	1,442.00€	2,343.00€	901.00€	62.48%
TOTAL	17,338.00€	23,820.00€	6,482.00€	37.38%

Tabela3.



Grafika 3.

4.2. Shpenzimet vjetore (janar – dhjetor 2023)

Në periudhën janar-dhjetor 2023, ka pasur shpenzime gjithsej:74,858.98€

Përkatësisht të ndara përgjatë muajve kemi:

Gjatë muajit janar ka pasur shpenzime në vlerë prej:.....3,594.09€

Gjatë muajit shkurt ka pasur shpenzime në vlerë prej:.....3,481.00€

Gjatë muajit mars ka pasur shpenzime në vlerë prej:.....3,607.40€

Gjatë muajit prill ka pasur shpenzime në **vlerë prej**:..... 3,824.12€

Gjatë muajit maj ka pasur **shpenzime në vlerë prej**: 3,587.82€

Gjatë muajit qershor ka pasur **shpenzime në vlerë prej**:.....4,260.27€

Gjatë muajit korrik ka pasur shpenzime në vlerë prej:.....4,185.42€

Gjatë muajit gusht ka pasur **shpenzime në vlerë prej**:..... 4,641.82€

Gjatë muajit shtator ka pasur shpenzime në vlerë prej:..... 4,970.17€

Gjatë muajit tetor ka pasur shpenzime në vlerë prej:..... 4,357.00€

Gjatë muajit nëntor ka pasur shpenzime në vlerë prej:..... 4,172.57€


Gjatë muajit dhjetor ka pasur shpenzime në vlerë prej:..... 30,177.29€

Paraqitja Tabelare e shpenzimeve të ndarë në muaj

Shpenzimet janar – dhjetor 2023

Janar	3,594.09€
Shkurt	3,481.00€
Mars	3,607.40€
Prill	3,824.12€
Maj	3,587.82€
Qershor	4,260.27€
Korrik	4,185.42€
Gusht	4,641.82€
Shtator	4,970.17€
Tetor	4,357.00€
Nëntor	4,172.57€
Dhjetor	30,177.29€
Totali	74,858.98€

Tabela 4.



Grafika 4.

***Paraqitja e detajizuar e shpenzimeve gjatë vitit 2023:**

- Paga, kontribute dhe tatime.....	46,380.09€
- Shpenzime komunale (rrymë dhe ujë).....	1,457.20€
- Material shpenzues për zyrë (letër, kuponë etj).....	1,017.10€
- Material për mirëmbajtje.....	258.35€
- Renovimi i tregut (subvencion).....	24,692.50€
- Shpenzime interneti.....	32.91€
- Tatami në fitim për vitin 2022.....	64.15€
- Derivate.....	20.00€
- Shpenzime bankare.....	513.28€
- Shpenzime administrative.....	99.00€
- Shpenzime tjera (Darka e fundvitit me punëtorët e ndërmarrjes).....	324.40€

Paraqitja Tabelare e shpenzimeve në formë të detajizuar për çdo muaj

Titulli i shpenzimit	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Totali
Paga, kontribute dhe tatime	3,361.09€	3,400.00€	3,400.00€	3,631.20€	3,419.10€	4,088.39€	3,906.50€	4,393.70€	3,924.73€	4,156.10€	3,965.40€	4,733.90€	46,380.09€
Kryme, uje	200.00€	35.00€	112.00€	113.00€	110.00€	109.00€	105.00€	110.00€	100.00€	89.20€	112.00€	262.00€	1,457.20€
Material shpenzues për zyrtë	--	13.00€	--	37.00€	15.80€	--	32.00€	--	902.50€	6.80€	--	10.00€	1,017.10€
Material për mirëmbajtje	--	--	--	--	--	--	--	36.10€	--	61.40€	17.75€	123.10€	258.35€
Renovimi i tregut	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	24,692.50€	24,692.50€
Shpenzime interneti	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	19.92€	12.99€	32.91€
Tatimi në lidhmë 2022	--	--	64.19€	--	--	--	--	--	--	--	--	--	64.19€
Derivate	--	--	--	--	--	20.00€	--	--	--	--	--	--	20.00€
Shpenzime bankare	33.00€	33.00€	31.25€	42.92€	42.92€	42.92€	42.92€	42.92€	42.92€	43.50€	37.50€	37.50€	313.28€
Shpenzime administrative	--	--	--	--	--	--	99.00€	--	--	--	--	--	99.00€
Shpenzime tjera	--	--	--	--	--	--	--	39.10€	--	--	--	285.30€	324.40€
Totali	3,594.09€	3,481.00€	3,607.40€	3,824.12€	3,587.82€	4,260.27€	4,185.42€	4,641.82€	4,970.17€	4,357.00€	4,172.57€	30,177.29€	74,858.98€

Tabela 5.

4.3. Pasqyra e të ardhurave për vitin 2023

31.12.2022

Saldo paraprake 4,859.68€

Të hyrat nga shërbimet dhe qiratë	47,588.00€ (4 qira borxh nga DM SHPK në vlerë 8,720.00€)
Të hyrat nga subvencioni	30,000.00€
Shpenzimet	50,166.48€
Renovimi i tregut	24,692.50€
Fitimi operativ	7,588.70€ (392.00€ deponohen në bankë më 2024) 7,196.70€ (Ilogaria bankare më 31.12.2023)

Tabela 6.

5. RAPORTI I ZYRËS SË PROKURIMIT

Në këtë raport janë të përfshira të gjitha aktivitetet e prokurimit të zhvilluara gjatë vitit 2023, duke përfshirë ato të vlerave minimale dhe të mesme.

Prokurime të vlerave të mëdha nuk janë të përfshira në këtë raport pasi që nuk janë zhvilluar procedura të atilla.

- Të gjitha procedurat e prokurimit janë zhvilluar duke zbatuar në plotëni Ligjin e Prokurimit Publik të Republikës së Kosovës Ligji Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 si dhe Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ të Prokurimit Publik (RRUOPP).

Procedurat e Prokurimit të udhëhequra nga ana e zyrtares së kontraktuar të Prokurimit, janë zhvilluar duke udhëhequr po ashtu parimet e përgjithshme të Ligjit të Prokurimit e të cilat janë: Ekonomiciteti dhe Efikasiteti dhe Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi,

Procedurat e Prokurimit për vitin 2023

Gjatë vitit 2023, janë zhvilluar gjithsej 4 procedura të prokurimit ndërkaq 4 Operatorë

Ekonomik janë shpërblyer me kontratë, pasi që kanë plotësuar kërkesat dhe kushtet sipas

Njoftimeve dhe Dosjeve të Tenderit për secilën procedurë.

Procedurat me vlerë minimale 2023

- Autoriteti kontraktues mund ta përdor procedurën me vlerë minimale për çdo kontratë

publike vlera e përlogaritur e të cilës është më pak se **1,000 euro / <1000**.

Procedurat me vlerë të vogël 2023

- Autoriteti kontraktues mund ta përdor procedura me vlerë të vogël për çdo kontratë

publike vlera e përlogaritur e të cilës është nga **$\geq 1,000 \text{ €}$ deri në $< 10,000 \text{ €}$** .

Procedurat me vlerë të mesme 2022

- Autoriteti kontraktues mund ta përdor procedura me vlerë të vogël për çdo kontratë

publike vlera e përlogaritur e të cilës është nga **$\geq 10,000 \text{ €}$ deri në $< 125,000 \text{ €}$** .

• Prokurimet me vlerë minimale 1,000 euro / <1000



• Prokurimet me vlerë të vogël $\geq 1,000$ € deri në $< 10,000$ €

Nuk është zhvilluar asnjë procedure prokurimi me vlerë të vogël.

- Prokurimet me vlerë të mesme $\geq 10,000$ € deri në $< 125,000$ €

Renovimi i tregut të qytetit

23,152.50€

ANEKS 1

(Pamje nga renovimi i hapësirave të tregut në Mitrovicë)














































NPL “Tregu” Sh.A., Mitrovicë

Janar 2024

Mitrovicë

Kryeshefi Ekzekutiv

Musa Preteni

**NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE
“TREGU” Sh.A., MITROVICË**

PLANI I PUNËS PËR VITIN 2024

Mitrovicë, dhjetor 2023

Vizioni

Ofrimi i shërbimeve cilësore, të sigurta dhe efikase për tregtarët dhe blerësit në hapësirën e tregut në komunën e Mitrovicës, duke përdorur mekanizmat që kemi në dispozicion.

Misioni

Shërbime të mira në pajtim me praktikat e avancuara për të gjithë shitësit dhe blerësit brenda hapësirës së tregut të komunës së Mitrovicës, duke ofruar shërbime me çmime të përballushme për shitësit që shfrytëzojnë këtë hapësirë.

Filozofia

Në qendër të vëmendjes kemi shitësit, me qëllimin që t'iu ofrojmë ambient të sigurt, të përshtatshëm dhe kushte të mira për zhvillimin e veprimtarisë së tyre tregtare;

Po ashtu në vëmendjen tonë janë edhe qytetarët që frekuentojnë hapësirën tonë për t'u furnizuar me produkte të ndryshme nga ato ushqimore dhe të gjitha llojet tjera që ofrohen nga shitësit në treg. Qëllimi është që kjo hapësirë të jetë creative, e pastër dhe me kushte optimale për të gjithë qytetarët;

Punonjësit tanë i çmojmë dhe u ndihmojmë në arritjen e potencialit të plotë të tyre;

Me profesionalizmin tonë mundohemi që çdo veprim ta bëjmë me përsosmëri;

1. HYRJE

1.1 Përmbledhja ekzekutive

Ky Plan i Punës është përgatitur në aspektin strategjik dhe operacional të tij nga Menaxhmenti Ekzekutiv i NPL “TREGU” Sh.A., Mitrovicë dhe i miratuar nga Bordi i Drejtorëve (BD) të Ndërmarrjes. Duke respektuar Ligjin për Ndërmarrjet Publike në Kosovë, ky Plan Biznesi i dërgohet Ministrisë së Ekonomisë (ME) si dokument informativ.

Plani i Punës përshkruan qëllimet, strategjitë dhe aktivitetet e propozuara të cilat Ndërmarrja synon t'i arrijë gjatë vitit 2024 si dhe planet e detajuara të veprimeve/aktiviteteve të cilat do të ndërmerren në mënyrë që të arrihet realizimi i objektivave të parapara në këtë plan.

Menaxhmenti i Ndërmarrjes zotohet në implementimin e këtij Plani dhe planifikon që të bëjë monitorimin e tij në baza të rregullta të parapara me ligj. Në afatin gjashtëmujor ndërmarrja do të bëjë rishikimin e Planit të Punës me qëllim të përmbushjes së planit njëvjeçar të vitit 2024.

NPL “Tregu” Sh.A., Mitrovicë po ballafaqohet me sfida të shumta, siç janë mungesa e stafit adekuat për kryerjen e të gjitha punëve brenda kompanisë, si mungesa Zyrtarit Kryesor Financiar, mungesa e Sekretarit, mungesa e Auditorit të Brendshëm, krejt kjo për shkak të mungesës së mjeteve financiare për t'i mbuluar këto pozita. Po ashtu ndërmarrja përballet edhe me probleme sa i përket zvogëlimit të vazhdueshëm të numrit të shitësve të cilët po gjejnë alternativa tjera për të zhvilluar veprimtarinë e tyre.

Gjatë vitit 2024 ndërmarrja do të vazhdojë përmirësimin e ambientit për shitësit dhe blerësit, si dhe do të ndërmarrë hapa për informimin e shitësve ilegalë për t'i njoftuar rreth kushteve që ofron tregu për ta, që jemi të bindur se është ambient shumë më komod dhe i duhur për shitësit për veprimtarinë e tyre. Të ardhurat dhe shpenzimet e Kompanisë janë analizuar nga menaxhmenti. Që të arrijë qëllimet e saj kryesore Kompania planifikon të arrijë të hyrat e faturuara në vlerë 24 mijë euro brenda vitit 2024, dhe 31,116 euro nga qiratë.

Ndërmarrja do të vazhdojë me aplikimin e politikave të duhura me qëllim të ngritjes së normës së arkëtimit, në vitin 2024 në 100%.

1.2 Historiku i NPL “Tregu” Sh.A., Mitrovicë

NPL “Tregu” Sh.A., Mitrovicë ka një histori të gjatë të funksionimit që nga vitet e paraluftës e deri në ditën e sotme. Ndërmarrja deri në vitin 1999 ka qenë pjesë e “Standard”, një ndërmarrje e madhe që ka përfshirë disa fushëveprimtari, përfshirë edhe sektorin e pastrimit dhe mirëmbjtjes së qytetit. Nga viti 1999 është krijuar si ndërmarrje e pavarur me emrin NP “Tregu”, kurse së fundi NPL “Tregu” Sh.A., Mitrovicë, pra Ndërmarrja Publike Lokale “Tregu” Sh.A., Mitrovicë.

Ndërmarrja për disa vite të pasluftës ka operuar në një lokacion tjetër nga aktuali, më saktësisht tek vendi i njohur si “xhamia e zallit”, kurse nga viti 2009 operon në lokacionin aktual, në rrugën “Adem Voca” në Mitrovicë.

Vitet e pasluftës ka funksionuar në bazë të ligjeve të UNMIK-ut, kurse nga viti 2009 në bazë të Ligjit për Ndërmarrje Publike, nr.03/L-087.

Numri i punëtorëve pas luftës ka qenë shumë më i lartë se sa tani. NPL “Tregu” Sh.A., Mitrovicë tani ka gjithsej 9 punëtorë, shtuar kësaj edhe kryeshefi ekzekutiv dhe 4 anëtarë bordi. Fatkeqësisht pozitat e rëndësishme si Zyrtari Kryesor Financiar, Sekretari, Auditori dhe Zyrtari Ligjor nuk janë të mbuluara.

NPL “Tregu” Sh.A., Mitrovicë i është mirënjohës komunës së Mitrovicës për mbështetjen që po e bën në realizimin e funksionimit dhe arritjes së objektiveve.

NPL “Tregu” Sh.A., Mitrovicë vepron me numër unik identifikues 810360264, me seli në Mitrovicë, rruga “Adem Voca”.

1.3. Qëllimet dhe Objektivat Strategjike

Ndërmarrja jonë funksionon me vendim-marrje dhe llogaridhënie tek Bordi i Drejtorëve, në përputhshmëri me principet e qeverisjes së përbashkët.

NPL “Tregu” Sh.A., Mitrovicë ka përcaktuar qëllimet kryesore strategjike si në vijim:

- Ofrimin e shërbimeve sa më efikase për shitësit dhe blerësit në hapësirën e tregut në Mitrovicë;
- Arritjen e qëndrueshmërisë financiare;
- Krijimin e një ambienti të favorshëm të punës për të gjithë të punësuarit
- Rritja e numrit të shitësve në treg, përmes ofrimit të shërbimeve dhe ambientit më të mirë;
- Modernizimi i kapaciteteve teknike dhe resurseve humane.

Ne planifikojmë që qëllimet strategjike të lartpërmendura t'i realizojmë duke shfrytëzuar resurset e Ndërmarrjes por edhe përmes mbështetjes nga komuna e Mitrovicës dhe donatorëve potencial.

Ndërsa deri në vitin 2024, Kompania ka paraparë përmbushjen e objektivave strategjike deri në nivelin në vijim:

- Rritjen e shkallës së arkëtimit në 99%.

Për realizimin dhe arritjen e objektivave të parapara në këtë Plan kompania ka marrë parasysh faktorët e brendshëm dhe të jashtëm të cilët lidhen me

performancën e kompanisë, andaj ka bërë edhe këtë analizë (SËOT) me qëllim të identifikimit të dobësive dhe rreziqeve në njërin anë si dhe përparësive dhe mundësive në anën tjetër.

Tabela 1. Analiza SWOT

<p>S</p> <p><u>Përparësitë:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> • Tradita/përvoja në sektorin e ofrimit të shërbimeve për shitësit dhe blerësit, • Ambient i përshtatshëm për shitësit, • Treg të sigurt, • Mbështetje nga Partnerët si: komuna e Mitrovicës. • Përparësia e Kompanisë në sektorin e shërbimeve më të lira për shitësit se sa dyqanet private dhe trotuaret, 	<p>Ë</p> <p><u>Dobësitë:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> • Mungesa e investimeve në trajnimin dhe zhvillimin profesional të stafit. • Tavolina të vjetëruara , • Zhvillimi i veprimtarisë tregtare vetëm ditën e shtunë, derisa 5 dita tjera tregu nuk shfrytëzohet nga shitësit për arsye të ndryshme, • Ulja e vazhdueshme e numrit të shitësve; • Borxhet e akumuluar ndër vite në ATK, KRU “Mitrovica”
<p>M</p> <p><u>Mundësitë:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> • Përmirësim të infrastrukturës dhe kushteve të punës; donacionet nga komuna e Mitrovicës dhe donatorët e Jashtëm, • Bashkëpunimi me kompanitë e sektorit si brenda ashtu edhe jashtë shtetit, • Aktivitetet e reja të veprimtarisë 	<p>T</p> <p><u>Rreziqet:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> • Rreziku nga konkurrenca në vendet ku shitet ilegalisht jashtë hapësirës së tregut, • Ngritja e tensioneve sociale apo politike, • Fatëkeqësitë natyrore (tërmetet, vërshimet etj.), • Borxhet tatimore të kompanisë.

Me qëllim të përmirësimit të performancës NPL “Tregu” Sh.A., Mitrovicë planifikon që të shfrytëzoj maksimalisht përparësitë dhe mundësitë, kurse të minimizoj dobësitë dhe rreziqet. Në ndërkohë do të punohet në drejtim të eliminimit të dobësive aty ku ka mundësi, dhe të njëjtat t’i kthejmë në përparësi.

2 SHËRBIMI TEKNIK

2.1 Parashikimi i kërkesës për Shërbime në hapësirën e tregut në Mitrovicë

NPL “Tregu” Sh.A., Mitrovicë do të vazhdoj edhe në vitin 2024 të ofrojë shërbime sa më cilësore për të gjithë shitësit dhe blerësit brenda hapësirave të ndërmarrjes në Mitrovicë.

Ndërmarrja planifikon që brenda vitit 2024 të ketë rritje të numrit të shitësve në treg, përmes ofrimit të shërbimeve sa më cilësore dhe ambientit për të gjithë shitësit dhe blerësit. Kjo rritje e numrit të shitësve që planifikojmë të ndodh, sidomos në periudhën e verës, kërkon angazhim shtesë të menaxhmentit dhe gjithë stafit, dhe planifikojmë se kemi kapacitete për të përballuar një lëvizje të tillë progresive.

Tabela 1.

Indikatoret operativ të Performancës në vitin 2024

Tabela 2. Rritja e numrit të konsumatorëve gjatë 2024

PËRSHKRIMI	VITI	
	2024	
Shërbime për shitësit		
Shitësit e rinj në treg	20-30	
Total	20-30	

Gjatë periudhës planifikuese 2023, pritet që numri i shitësve/tregtarëve të rinj të rritet për 20-30.

2.1 Kontrollimi i shërbimit

Gjatë periudhës planifikuese 2023-2025, ndërmarrja do të ndërmerr masa për kontrollimin e shërbimeve të ofruara dhe shndërrimin e tregut në një hapësirë kreative për shitësit përmes përgatitjes së një strategjie të hollësishme.

Shitësit ilegalë, pra ata shesin në hëpsira publike, si rrugë dhe trotuare, dëmtojnë kompaninë, pasi një pjesë e hapësirës së tregut është e pashfrytëzuar dhe në dispozicion për ta. Ndërmarrja do të ndërmerr hapa informimi për këta shitës ilegalë me qëllim që t'u tregojmë se ofrojmë ambient shumë të përshtatshëm për ta dhe me çmime të volitshme.

Presim që përmes strategjive specifike dhe informimit në bashkëpunim me institucionet përkatëse, të zvogëlojmë numrin e shitësve ilegalë të cilët janë potencial për rritjen e inkasimit në ndërmarrje.

Menaxhimi i mirë i tregut nga ndërmarrja jonë nënkupton:

- Ambient i përshtatshëm për shitje,
- Tavolina dhe hapësirë të mjaftueshme,
- Hapësirë më kushte për shitjen e produkteve të qumështit.
- Toaleta tërësisht funksionale,
- Rrymë dhe ujë për shitësit dhe blerësit.

3. SHËRBIMI KOMERCIAL

3.1. Plani për rritjen e faturimit dhe inkasimit

Planifikimi për rritjen e faturimit është bërë konform informacioneve të ofruara nga sektori teknik i planifikimit dhe zhvillimit. Në vitin në vazhdim pritet që faturimi në fund të vitit 2024 të arrijë në 24,000.00€.

Nga ana tjetër është paraparë që faturimi (shërbimet e ofruara/kryera ndaj konsumatorëve) të pësojë një rritje e cila e shprehur në vlerë monetare do të arrijnë në 24,000.00€ për vitin 2024, ndërsa deri në fund të vitit 2025 – 25,000.00€. Të gjitha këto të dhëna janë parashikuar duke u bazuar në faktin se numri i konsumatorëve/tregtarëve synohet të rritet sipas parashikimeve të bëra nga operativa.

3.2. Menaxhimi i kërkesave/ankesave të konsumatorëve

Sektori për konsumatorë do të vazhdojë me aktivitetet drejt përmirësimit të menaxhimit të kërkesave/ankesave gjithnjë duke respektuar dhe zbatuar Rregulloret e brendshme të ndërmarrjes. Në lidhje me respektimin e procedurave për pranimin, përpunimin dhe kthimin e përgjigjeve ndaj konsumatorëve, sektori për konsumatorë/tregtarë parashih formimin e një komisioni i cili ekskluzivisht do të mirrej me zgjidhjen e ankesave/kërkesave të konsumatorëve/tregtarëve.

4. SHËRBIMI FINANCIAR

Plani financiar i afarizmit për vitin 2024 është bërë në bazë të vlerësimit të realizimit të të hyrave dhe shpenzimeve deri në TM-3/2023 si dhe kontratave të realizuara deri në muajin Shtator 2023, si dhe në bazë të parashikimeve për aktivitetet të cilat do të ndodhin në vitin 2024.

Të hyrat të cilat do të jenë dominante në përcaktimin e rezultateve financiare në vitin 2024 do të jenë të hyrat nga grumbullimi i inkasimit dhe qiratë.

Treguesit Financiar ('000€)	Plani Biznesit 2024
Të Hyrat e Faturuara	24,000.00€
Qiratë	31,116.00€
Subvencionet	0.00
Totali i të hyrave të planifikuara	55,116.00€
Shpenzimet për Mallra dhe Shërbime	48,165.50€
Fitimi/Humbja operative	6,951.00€

4.1. Analiza e të Ardhurave

Të Hyrat e Planifikuara për Mallra dhe Shërbime të NPE "Tregu" Sh.A., Murraviçë -së për vitin 2024

Emërtimi	2023	2024
	(EUR)	(EUR)
Faturimi (total)	23,820.00	24,000.00
Arkëtimi (total)	23,820.00	24,000.00

Qiratë	31,116.00€	31,116.00€
% e arkëtimit/Faturim	100%	100%
Shpenzimet për Mallra dhe Shërbime	48,165.50€	48,165.50€

4.2. Të hyrat nga subvencionet

NPL "Tregu" Sh.A., Mitrovicë planifikon që të kërkojë subvencione nga komuna e Mitrovicës me qëllim të investimeve kapitale në hapësirën e tregut të qytetit.

4.3. Analiza e Shpenzimeve për Mallra dhe Shërbime

Planifikimi i shpenzimeve për mallra dhe shërbime për vitin 2024 është bërë me kujdes dhe për bazë janë marrë faktorët të cilët do të kenë ndikim të drejtëpërdrejtë në ngritjen ose zvogelimin e shpenzimeve operative të kompanisë.

Shpenzimet e Planifikuara për Mallra dhe Shërbime të KRM-së për vitet 2023 – 2025

Emërtimi	Njësia	2024
Bruto Pagat	€	45,380.00
Energjia elektrike dhe ujë	€	1,300.00
Derivatet	€	0.00
Kosto e komunikimit (telefon, internet, etj.)	€	0.00
Mirëmbajtja dhe riparimet.	€	5,000.00 (Parashihet që kjo të bëhet me mjetet e mbetura të subvencionit të vitit 2023)
Të tjera: Blerje dhe mirëmbajtje e kompjuterëve, marketing, punëtori, staf, shërbime juridike, reprezentacion, tatim në prone.	€	1,485.5
Total:	€	48,165.50€

4.4. Plani i investimeve vetanake

Kompania edhe përkundër vështirësive të lartpërmendura, parashih që të ketë investime në vlerë prej 5,000.00€ në vitin 2024 nga mjetet e subvencionit nga viti i kaluar, si dhe investime tjera në rast të subvencioneve të mundshme nga komuna e Mitrovicës apo institucionet tjera. Blerja e mjeteve të punës dhe riparimet brenda hapësirës së tregut.

5. SHËRBIMI I PLANIFIKIMIT & ZHVILLIMIT – PLANI I INVESTIMEVE

5.1. Plani i Investimeve në 2024

ID e Projektit dhe Titulli:	Blerja e mjeteve të punës dhe riparimet brenda hapësirës së tregut.
Afati kohor i përfundimit:	Gjatë vitit 2024
Vlera e përlogaritur:	5,000.00€
Burimi i financimit:	Vetanak
Përshkrimi:	Blerja e mjeteve të punës dhe riparimet brenda hapësirës së tregut.

6. SHËRBIMI ADMINISTRATIV

6.1. Plani i menaxhimit të personelit

NPL “Tregu” Sh.A., në Mitrovicë gjatë vitit 2023 tërë procesin e punës në menaxhimin e hapësirës së tregut e ka përmbyllë me 9 të punësuar, ndërmarrja për vitin 2024 nuk parasheh të shtojë numrin e punëtorëve.

Raportet, përgjegjësitë, detyrimet dhe kompetencat midis stafit janë të përcaktuara mbi bazën e Skemës Organizative.

Personeli, që kryen punët dhe detyrat në NPL “Tregu” Sh.A., Mitrovicë është heterogjen:

- Nga aspekti i përgatitjes profesionale;
- Nga aspekti i shkathtësive,
- Produktivitetit dhe efikasitetit në punë;

6.2. Shërbimet e sigurisë fizike të objekteve

Sigurimi fizik i objekteve brenda hapësirës së tregut për vitin 2024 do të bëhet përmes sistemit të kamerave digjitale dhe alarmeve që monitorohen nga një kompani private e kontraktuar për periudhë 1 vjeçare. Punëtorët e sigurimit fizik të ndërmarrjes kalojnë në punën e ndihmës inkasantëve deri në përgatitjen e plotë që të shërbejnë si inkasantë.

